



KOPSHTI PARASHKOLLOR “MILINGONAT”

SHPALL

KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE

Nr.	Grup-mosha	Numri i fëmijëve
1.	0,9 muaj – 2 vjec	21
2.	2-3 vjec	44
3.	3-4 vjec	40
4.	4-5 vjec	40
5.	5-6 vjec	24

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
2. Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
3. Dëshmi që jeni banorë të lagjes Kodra e Trimave (vërtetimi nga Bashkësia Lokale; faturë të shërbimeve, dëshmi apo kontratë të pronës/vendbanimit etj)
4. Dokumentet tjera valide të lëshuara nga institucionet relevante për të dëshmuar kategoritë tjera.

Në mungesë të këtyre dokumenteve, aplikacioni nuk konsiderohet i plotë dhe nuk trajtohet.

Kriteri bazë për pranim është të jetë banorë i lagjes. Si dhe do të ndiqet rradha e aplikimit (i pari që aplikon, i pari pranohet).

Çmimi i çerdhes është 100 euro në muaj.

Por në bazë të të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit, Komuna e Prishtinës do të subvencionoj një pjesë të pagesës:

1. Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.
2. Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.

3. Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.
4. Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro nuk do subvencionohen nga Komuna dhe paguajnë pagesën e plotë.
5. Prindërit të cilët kanë biznese funksionale diskualifikohen nga subvencionet si më lartë.

Pranimi i dokumenteve bëhet prej datës 12 Mars deri më 18 Mars 2019. Dokumentet pranohen çdo ditë pune nga ora 09:00 -15:00.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Prindërit të cilët do të kërkojnë subvencionimin e pagesës do të kërkohen të sjellin dokumente shtesë për të vërtetuar gjendjen ekonomike dhe të ardhurat mujore.

Vërejtje: Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë që dorëzohen do të verifikohen nga institucionet përkatëse dhe nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit apo dëshmive do të humbni të drejtën për subvencionim të pagesës.